

Matteo Mandalà

Arbërishtja në rrjedhë të shekujve



Matteo Mandalà

Arbërishtja
në rrjedhë të shekujve



Parathënje nga
Gëzim Gurga



Naimi

Treguesi i lëndës

Parathënë nga *Gëzim Gurga*

f. 7

I	Mbi gjuhën e Lekë Matrangës	25
II	Disa vërejte mbi të folmen arbëreshe të Munxifsit përmes veprave të Nikollë Filjes	79
III	Disa vërejtje gjuhësore mbi veprën shqip të Nikollë Ketës	107
IV	Arbërishtja dhe osmanishtja: një kontakt gjuhësor mesjetar	133
V	<i>Shqip, shqipëtar e shqipini</i> në <i>Fjalorin</i> (1702) e Francesco Maria da Lecce-s	203
VI	Fjalori «Leksiko» (1763) i Nikollë Ketës dhe turqizmat në arbërishtë	217
VII	Mbi sistemin foljur të së folmes arbëreshe të Kuntisës	245
VIII	Fonologjia e së folmes së Kuntisës	261
Bibliografia		309

II

Disa vërejtje mbi të folmen arbëreshe të Munxifsit përmes veprave të Nikollë Filjes

1. Parashtresë

Nikollë Filja lindi në Munxifs (it. Mezzojuso) më 14 maj 1693. Pasi studioi gjuhët greke dhe latine, retorikë, filozofi dhe teologji duke u diplomuar me titullin “doktor”, Filja në vitin 1721 u transferua në «trojet arbëreshe të Kieutit, në dioqezën e Larinos», me të fituar konkursin e shpallur për vendin e kryepriftit të kishës së Shën Gjergjit të atij ngulimi arbëresh. Pas nëntëmbëdhjetë vjetësh qëndrimi në Kieuti, u kthye në Munxifs në vitin 1727, sepse e thirri Arkipeshkvi i Palermos, imzot Giuseppe Gash (1635-1729). Në fshatin e lindjes Filja kreu detyrën e kryepriftit pa ndërprerje deri kur vdiq në vitin 1769, duke u kujdesur edhe për «kishën e Shën Nikollës në dioqezën e Palermos»¹. Gjatë kësaj periudhe Filja iu kushtua historisë së ngulimeve arbëreshe të Sicilisë, sidomos fshatit të tij të lindjes, duke shkruar në vitin 1750 një dorëshkrim

¹ Nicolò Figlia, “Breve ragguaglio della terra di Mezzojuso”, (a cura di Francesco Masi e con una nota introduttiva di Matteo Mandalà), në Nuove Effemeridi. *Rassegna trimestrale di cultura, anno II, n. 6, 1989/2, Palermo, 1989.* Për ekzistencën e këtij dorëshkrimi na njofton Nicolò Chetta në *Tesoro di Notizie su de' Macedoni*, Introduzione di Matteo Mandalà, Trascrizione di Giuseppa Fucarino, Comune di Contessa Entellina, 2002, f. 456-457.

me “Përshkrimin e shkurtër të Munxifsit” ku jepen të dhëna mbi historinë e themelimit të këtij ngulimi arbëresh, me disa shënime mbi historinë e rtitit lindor greko-bizantin në Sicili, si edhe mbi veprimtarinë ekumenike të priftërinje arbëreshë në Shqipëri prej themelimit në Munxifs të manastirit bazilian nga Andrea Reres deri në themelin e Seminarit Arbëresh në Palermo nga at Gjergj Guxeta në vitin 1737.

Në qendër të këtij rindërtimi historik Filja vendosi historinë e kishave të shumta që kishte asokohe Munxifsi², duke përshkruar marrëdhëniet mes komuniteteve arbëreshëve të Italisë dhe rtitit bizantin me synimin për të vënë në pah rëndësinë e traditave kulturore dhe fetare të arbëreshëve, për të mbrojtur pavarësinë e kishës italo-bizantine nga ajo latine, për të konfirmuar besnikërinë ndaj Papës së Romës dhe arkipeskëve të Palermos dhe, së fundi, për të hedhur poshtë akuzat e disa ipeshkëve dhe priftërinje sicilianë të rtitit latin mbi gjoja përkatësinë e arbëreshëve në Kishën skizmatike të Lindjes³.

Pikërisht gjatë atyre viteve ishte rindezur debati mes besimtarëve të rtitit latin dhe atyre të rtitit bizantin, debat që i shtyu intelektualët arbëreshë t’ia hynin studimit të historisë, të kulturës

² Mes kishave të rtitit bizantin Filja përmend atë të Shën Mërisë Hirplotë (1490/1500), të Shën Nikollës (1520) dhe kapelës përkartëse (1550), të Shën Rrokut (1530), të Kryqit të Shenjtë (1634), të Shën Anës, të Shën Mërisë Zonjë e Qiejve që ndodhej mbi malin me emrin *Brinja*, si edhe disa kisha të tjera të vogla jashtë qendrës së banuar; si kishë të rtitit latin përmend vetëm atë të Shën Anunciatës. Shih Nicolò Figlia, *Breve ragguaglio*, vep. cit., f. 84-86.

³ Eshtë interesante të vihet re sesi Filja – ndryshe nga priftërinjtë e tjerë arbëreshë si p.sh. Keta – nuk përdorte argumente polemike, por vinte në pah elementet e përbashkëta që karakterizonin marrëdhëniet mes klerit dhe besimtarëve arbëreshë nga njëra anë dhe klerit e besimtarëve të rtitit roman nga ana tjetër. Kështu shkruante autori ynë: “Gode per la grazia di Dio somma pace ed unione col reverendo archiprete e clero e popolo latino con somma edificazione di tutta la terra pervenuta all’orecchio del nostro Sommo Pontefice Romano e dalli Arcivescovi di Palermo ed ultimamente dei Rev.mi Visitatori [...]”: Nicolò Figlia, *Breve ragguaglio*, vep. cit., f. 86.

dhe të gjuhës shqipe, si edhe të ndërmerrnin disa kërkime me karakter ndërdisiplinar me vlera të veçanta edhe sot e gjithë ditën, e përgjithësisht të promovonin një veprimtari të gjerë intelektuale të pashoqe deri atëherë.

Frymëzuesi dhe drejtuesi i gjithë kësaj veprimtarie ishte at Gjergj Guxeta, i cili pasi ngriti Oratorion Filipine për priftërinjtë e pamartuar të rtit bizantin, themeloi në vitin 1737 Seminarin Arbëresh të Palermo, ku jo vetëm formoheshin priftërinjtë arbëreshë të rtit bizantin, por zuri fill një program i jashtëzakonshëm kërkimesh mbi identitetin e arbëreshëve. Vëmendje e veçantë iu kushtua jo vetëm traditave fetare, por edhe studimit të gjuhës shqipe, folklorit, dokeve, historisë dhe letërsisë shqipe.

Në këtë kontekst historik lindin veprat Filjes, i cili pikërisht gjatë viteve '30 shek. XVIII zuri të bashkëpunojë me at Gjergj Guxeten për themelimin e Seminarit ku u kurorëzuan objektivat e tij. Falë respektit dhe vlerësimit të madh që gjëzonë, pasi vdiq rektori i parë i Seminarit, Petro Andrea, një shqiptar nga Himara, Filja u propozua si kandidat për t'u emëruar rektor, mirëpo në fund u emërua në atë post nxënësi i preferuar i at Gjergj Guxetës Pal Maria Parrino⁴. Me këtë të fundit dhe me Nikollë Ketën Filja lidhi marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi. Të tre bashkë vijuan punën në zhvillimin e programit kulturor që kishte nisur Guxeta, duke filluar me formimin rigoroz të të rinjve arbëreshë që nxiteshin

⁴ «Aveva egli [Guzzetta] potuto stabilire nelle suddette regole che il rettore, gli assistenti Superiori ed i deputati del seminario sempre fussero della sua patria. Ma egli per primo rettore vi mise il dotto beneficiale greco di questa parrocchia Sacerdote dottor don Pietro D'Andrea, nativo di Cimarra dell'Epiro, fin dove si estendevan l'amo- rose ale del zelo universale del p. Giorgio. Morto lui, gli fe' succedere il degnissimo palazzioto sacerdote beneficiale della medesima parrocchia dottor don Paolo M. Prifti o sia Parrino in preferenza dei due pretensori rev. arciprete dottor don Nicola Figlia di Mezzojuso e rev. arciprete della Piana don Giorgio Stassi, alunno già di S. Atanasio, e nipote dell'allor vivente arcivescovo monsignor Matranga, che soltanto dopo la morte di quello risultò beneficiale e rettore, suo successore attuale».: Nicolò Chetta, *Tesoro di notizie*, vep. cit., f. 532.

të studionin kulturën dhe gjuhën shqipe, të respektonin dhe të mbronin traditat të parëve si edhe të zhvillonin ritin bizantin duke përdorur gjuhën shqipe në funksionet liturgjike. Dëshmi e kësaj veprimtarie të Filjes janë pikërisht dy dokumentet gjuhësore dhe letrare, ndër më të rëndësishmet e gjysmës së parë të shek. XVIII, të shkruara në të folmen arbëreshe të Munxifsit.

2. Burimet dhe metoda

Së pari janë të nevojshme dy saktësime paraprake. Saktësimi i parë ka të bëjë me burimet e përdorura. Edhe pse janë marrë në analizë të dyja veprat e Filjes – pra *Kodiku i Kieutit*, që autori e shkroi mes viteve 1736-1739 botimin kritik të të cilit e përgatitëm në vitin 1995⁵, dhe *Vajtim' i Zonjësë Shën Mérî Virgjérë mbi malt Kalvarie*, një tekst në vargje që autori ynë shkroi në vitin 1763, frysmezuar nga një vepër dorëshkrim e poetit Jacopone da Todi⁶ –, jemi treguar të kujdeshshëm në shqyrtimin e të dhënavë gjuhësore që përmban Kodiku, pasi disa tekste që përfshihen aty nuk janë krijime mirëfilli arbëreshe, sepse përbajnë dy lloje kontaminimi: i pari vjen nga konteksti italian, pasi kemi të bëjmë me ndikime që rrjedhin prej teksteve italiane dhe siciliane që Filja përshtati arbërisht; i dyti ka të bëjë nga njëra anë me ndikimin që ushtruan në gjuhën e Filjes autorët gegë të shek. XVII-XVIII, sidomos veprë e Budit, nga ana tjetër me faktin se disa këngë të përshpirtshme të Kodikut shfaqin disa karakteristika të së folmes së Horës së Arbëreshëve, fshatit të autorit të tyre, kryepriftit Gjergj Nikollë Brankatit. Është e qartë se pikërisht ky lloj i dytë kontaminimi kërkon vëmendje më të madhe në mënyrë që të mos

⁵ Shih Nicolò Figlia, *Il Codice Chieutino*, a cura di Matteo Mandalà, Comune di Mezzojuso, Palermo, 1995. Citimet e Kodikut do të paraprihen nga sigla CC.

⁶ Për citimet e *Vajtim'* do të përdorim siglën V.

i veshim së folmes së Munxifsit karakteristika që nuk i përkisnin.

Saktësimi i dytë ka të bëjë me metodën e zbatuar: duke ndërmarrë një kërkim që përfshin filologjinë, historinë e gjuhës dhe dialektologjinë na është dashur ta vëmë theksin mbi aspektet diakronike, pra t'ia hyjmë një analize krahasuese që merr në konsideratë disa dukuri gjuhësore tipike për shqipen mesjetare dhe veçanërisht të folmet arbëreshe të Sicilisë. Në vend të kufizohemi thjesht me një renditje të dhënash që vështirë se do të na shpinte në rindërtimin e një të folmeje arbëreshe të shek. XVIII, për më tepër sot të zhdukur, parapëlqejmë ta zgjerojmë diskutimin duke marrë në shqyrtim disa momente më të përgjithshme të historisë së gjuhës shqipe.

Ky shënim paraprak na u duk i nevojshëm para se të pohojmë se arbërishtja e Munxifsit që dëshmohet në veprat e Filjes pasqyronte qysh në shek. XVIII një gjendje gjuhësore shumë të ngjashme me atë që vihet re në komunitetet e tjera arbëreshe të Sicilisë: kemi të bëjmë nga njëra anë me një gjuhë strukturalisht arkaikë, të ngrirë nga shekulli XV kur arbëreshët u shkëputën nga mjedisi shqipfolës ballkanik, dhe nga ana tjetër me një gjuhë të hapur ndaj risive, sidomos leksikore, kryesisht terma diturorë dhe pjesërisht të imponuara nga kontakti me të folmet siciliane të provincës së Palermos ku ndodhet Munxifi.

Të folmet arbëreshe, me karakterin e theksuar konservativ që paraqesin, kanë përbërë gjithmonë një minierë të dhënash me vlerë të madhe për studimet historike në fushë të shqipes. Fakti që arbërishtja u shkëput nga trungu i shqipes ballkanike nga fundi i shek. XV, duke ndërprerë apo duke tjetërsuar zhvillimin e natyrshëm historik të shumë proceseve gjuhësore, shënon një tregues të vlefshëm për datimin dhe shtresimin e një sërë dukurish fonetike, gramatikore dhe leksikore.

Studimi i strukturës semantike të vjetër të leksikut është shfrytëzuar gjithmonë si një nga mjetet më efikase për rindërtimin e historisë së brendshme të gjuhës. Duke analizuar të dhënat e shumta që gjenden te *Fjalori i Da Lecce-s*, Matteo Mandalà arrin të zbulojë kuptime tashmë të zhdukura dhe të rindërtojë mjeshtërisht strukturën e plotë kuptimore të fjalëve dikur polisemantike *shqip*, *shqiptar* e *shqipini*, duke hedhur kështu përfundimisht dritë mbi historinë e zhvillimit të brendshëm të etnonimit të shqiptarëve. Në këtë kuadër studimet e Matteo Mandalasë të përfshira në këtë vëllim sjellin një kontribut të vyer në ndriçimin e historisë së fjalëve të vjetra të gjuhës shqipe.

(*nga parathënia e librit shkruar nga Gëzim Gurga*)

ISBN: 978-9928-234-37-7



9 789928 234377 >

Çmimi: 1500 lekë / 15 Euro